REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE DURRËS

NOTER VIOLA PETANI
ADRESA lagja nr. 3, sheshi " Liria ", qendra e biznesit "Best Co ", kati V
TEL: 0694053520

# VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

**Nr. repertori: 2326**

**Durres më 09/10/2024**

Ligjet referuese:

1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar

2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar

3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar

V202401396007922666З

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTERE VIOLA PETANI

PULLE TARIFE 200 LEKE R.SHQIPERISE

V202401396007922663

DATE 09/10/2024
NR REP 2326

**VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKT THEMELIMI DHE STATUTIN**

Në Durrës, sot në datën 09/Tetor/2024 para meje Noteres Viola I. Petani, në Zyrën Noteriale, me seli në Durrës, në adresën: Lagja Nr. 3, Sheshi "Liria", Qendra e Biznesit "Best Co", kati i 11-të, u paraqitën personalisht :

1. Z. **Luigi Bonato**, atësia Pietro, amësia Idelma, shtetas Italian, lindur në Montagnina, vendqendrimi në Shqipëri në: Kavajë, Golem, Zona Kadastrale nr. 1791, pasuria e paluajtshme nr. 9/130, lindur më 08/01/1958, madhor, gjendja civile i divorcuar, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me Pasaportë nr. YB0332519, lëshuar në datën 19/12/2016 nga Autoritetet e Republikës Italiane, e vlefshme deri në datën 18/12/2026.
2. Z. **Vincenzo Palmieri**, atësia Onofrio, shtetas italian, lindur në Massaua, vendqendrimi në Shqipëri në adresën: Tiranë, Njesia Administrative nr. 5, rruga "Ibrahim Rugova", shtepi private, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaportë nr. YA8828599 lëshuar nga Republika Italiane në datën 12/03/2016 e vlefshme deri në datën 11/03/2026.
3. Z. **Gian Luigi Onori**, atësia Dino, amësia Iolanda, shtetas italian, lindur në Tuscania, Itali, vendqendrimi në Shqipëri në adresen: Tiranë, me adresë: rruga e Kavajës, Nd. 229, H. 3, Njësia Administrative Nr. 7, Njësia Bashkiake Nr. 7, lindur më 04/06/1959, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me lejeqëndrimi nr. 267802 dhe nr. personal F93604002F, lëshuar nga Republika e Shqipërisë në datën 22/02/2023 e vlefshme deri në datën 22/02/2028, pajisur me pasaportë nr. YC3728048 lëshuar në datën 13/11/2023 nga Republika e Italisë e vlefshme deri në datën 12/11/2033.

Të pranishmit, me vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, Aktin e Themelimit dhe Statutin e "Emmaëay" sh.p.k, në tre njësi origjinale, bashkëlidhur.

Unë noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar nëpërmjet mjeteve të identifikimit, në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 *"Për Noterinë"*, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTERE

VIOL I. PETANI (KONA)

**AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "EMMAWAY"**

Në Durrës, **sot në datën 09/Tetor/2024, ne :**

1. **Z. Luigi Bonato**, atësia Pietro, amësia Idelma, shtetas Italian, lindur në Montagnana, vendqendrimi në Shqipëri në Kavajë, Golem, Zona Kadastrale nr. 1791, pasuria e paluajtshme nr. 9/130, lindur më 08/01/1958, madhor, gjendja civile i divorcuar, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, pajisur me Pasaportë nr. YB0332519, lëshuar në datën 19/12/2016 nga Autoritetet e Republikës Italiane, e vlefshme deri në datën 18/12/2026.
2. **z. Vincenzo Palmieri**, atësia Onofrio, shtetas italian, lindur në Massaua dhe banues në Itali, vendqendrimi në Shqipëri në adresën Tiranë, Njesia Administrative nr. 5, rruga "Ibrahim Rugova", shtepi private, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me pasaportë nr. YA8828599 lëshuar nga Republika Italiane në datën 12/03/2016 e vlefshme deri në datën 11/03/2026.
3. **z. Gian Luigi Onori**, atësia Dino, amësia Iolanda, shtetas italian, lindur në Tuscania, Itali, vendqendrimi në Shqipëri në Tiranë, me adresë: rruga e Kavajës, Nd. 229, H. 3, Njësia Administrative Nr. 7, Njësia Bashkiake Nr. 7, lindur më 04/06/1959, gjendja civile i martuar, madhor, me zotësi juridike dhe zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me lejeqëndrimi nr. 267802 dhe nr. personal F93604002F, lëshuar nga Republika e Shqipërisë në datën 22/02/2023 e vlefshme deri në datën 22/02/2028, pajisur me pasaportë nr. YC3728048 lëshuar në datën 13/11/2023 nga Republika e Italisë e vlefshme deri në datën 12/11/2033.

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i azhornuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" etj, **themelojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "EMMAWAY" sh.p.k.**

**Selia e** shoqërisë është në Kavajë, Golem, Zona Kadastrale nr. 1791, pasuria e paluajtshme nr. 9/130, kati përdhe'.

**Objekti** i shoqërisë është: konsulencë e personalizuar në fushat e të ushqyerit, shëndetit, mirëqenies dhe fitnesit, me fokus të veçantë në biohaking. Ofrimi i një gamë të plotë produktesh dhe shërbimesh, duke përfshirë suplemente, libra dhe zgjidhje inovative, të dizenjuara për të përmirësuar mirëqenien fizike dhe cilësinë e jetës së njerëzve të të gjitha moshave. Ofrimi i mjeteve dhe njohësve të vërtetuar shkencërisht për të optimizuar shëndetin fizik dhe mendor.

**Kohëzgjatja** e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është **pa afat.**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) euro, i përbërë nga 3 kuota**, të zotëruara nga:

1) nga Vincenzo Palmieri - 1 kuotë, me vlerë 30 euro, me 30% pjesemarrje ne kapitalin themeltar.
2) nga Gian Luigi Onori - 1 kuotë, me vlerë 30 euro, me 30% pjesemarrje ne kapitalin themeltar.
3) nga Luigi Bonato - 1 kuotë, me vlerë 40 euro, me 40% pjesemarrje ne kapitalin themeltar.

Shoqëria do të shtrijë aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqiperisë. Me Vendim të Asamblesë së përgjithshme mund të ndryshohet, krijohen ose anullohen në rast se janë çelur, Seli, Filiale, Agjenci dhe perfaqësi në qytete të tjera të Republikës së Shqipërisë.

**Administrator i shoqërisë emërohet z. Luigi Bonato,** i cili deklaron se pranon rolin e ngarkuar dhe se nuk ekzistojnë shkaqe të ligjshme që mund ta shpallin të pavlefshme.

GIAN LUIGI ONORI        BONATO LUIGI        VINCENZO PALMIERI

**Afati i emërimit të administratorit është pesë vjet**. Administratori emërohet sot në datën e nënshkrimit të aktit të themelimit. Emërimi i prodhon efektet pas regjistrimit ne Qendrën Kombetare të Regjistrimit (Neni 95, pika e parë e Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare")

**Administratori përfaqëson shoqërinë tregtare, kryen veprimtarinë tregtare të shoqërisë duke zbatuar politika tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.**

Në rastet e kryerjes së veprimtarive të rëndësishme që kanë të bëjnë me shpenzime në vlera të mëdha dhe që lidhen me transkaksione të pasurive të paluajtshme, shkëmbime apo çdo lloj tjetërsimi të tyre, zmadhime të kapitalit themeltar, venie garancie hipotekore apo bankare, marrje kredie, marrje pjesë në tendera brenda vendit apo ndërkombetare, Administratori i emëruar kryen veprime bankare vetëm mbi bazën e Vendimit me shkrim të Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, i cili duhet të jetë legalizuar nga Noteri.

Pjesët e kapitalit themelor janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie ligjore ose testamentare sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku gëzon të drejtën e shitjes se kuotave jashtë ortakërisë mbi bazen e vendimit të Asamblesë së Përgjithshme dhe sipas proçedurave që janë përcaktuar në Statutin e shoqërisë.

Ky Akt Themelimi redaktohet në dy njësi origjinale, me përmbajtje e vlera të njëjta juridike dhe pasi lexohet me zë miratohet nga unë ortaku i vetëm themelues.

Ortakët themeluesë

GIAN LUIGI OMORE

VINCENZO PALMIERI

BONAFIC LUIGI